



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228480

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406180

C.nr.125/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rr. ... të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania V... SH.P.K me seli në Fushë Kosovë, rr. ..., kundër të paditurit R.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim dëmi, jashtë seance më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së të paditurit R.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rr. ... të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania V... SH.P.K me seli në Fushë Kosovë, rr. ..., ka paraqitur padi me datë 16.03.2017, kundër të paditurit R.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

Gjykata me datë 04.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses F.L, ndërsa për të paditurin R.A nga fletëkthesa e datës 07.02.2024, është konstatuar se i njëjti ka vdekur.

Meqenëse është konstatuar se ka vdekur i padituri dhe aktualisht nuk dihen trashëgimtarët e tij, tani të ndjerit R.A, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.125/17, me datë 04.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.